



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:132182

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792697

KPPP.nr.2331/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit D.P.Z. “El - Medina”, me NUI: 810997322, me seli në rr. “Edit Durham”, në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Asman Hoxha, avokat nga Prizreni, kundër debitorit T.RR. B.I. (N.H “Genisi”), me NUI: 810739469, me seli në rr. “Ukë Bytyqi”, në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nexhat Elshani, avokat nga Prizreni, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.345/2020 të datës 29.09.2020 të Përmbartuesit Privat Mehdi Reshani me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 06.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit T.RR. B.I. (N.H “Genisi”), ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.345/2020 i datës 29.09.2020, i Përmbartuesit Privat Mehdi Reshani dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit D.P.Z. “El - Medina”, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.345/2020 të datës 29.09.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. FSH-012018 të datës 23.05.2018, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 2,380.00 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, nga data e faturimit e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbartimit, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e këtyre mjeteve në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe

shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, derisa të kryhet në tërësi obligimi i të njëjtit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ku ndër të tjerash ka deklaruar se fatura e cekur në propozim nuk paraqet dokument përmbartimor, për faktin se vetëm është cilësuar shuma e pagesës, mirëpo nuk është përmendur ndonjë fakt tjetër që kanë të bëjnë me kompensimin e saj. Më tutje ka theksuar se fatura e propozuar është kopje dhe se e njëjta nuk i përmban të gjitha elementet ligjore për t'u konsideruar dokument përmbartues. Ka shtuar se shuma e mbetur për pagesë nuk e tejkalon shumën mbi 1,000.00 €, ndërsa në propozim për përmbartim borxhi theksohet se është 2,300.00 €. Gjykatës i ka propozuar që urdhrin për përmbartim ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa këtë çështje ta udhëzoj në kontest civil.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar se debitori në prapësimin e paraqitur nuk e kundërshton faktin se i ka borxh kreditorit, mirëpo e konteston shumën e saj, por që këtij prapësimi nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë materiale, me të cilën do ta vërtetonte një pretendim të tillë. Në lidhje me kërkesën e debitorit që gjykata këtë çështje përmbartimore t'i udhëzoj palët në procedurë kontestimore, e njëjta nuk qëndron, për faktin se pala debitore mundet që të drejtat e tij t'i realizojë në procedurë kontestimore, pa pasur nevojë të pres një vendim në procedurë përmbartimore. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të bazuar dhe të obligohet që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, duke përfshirë edhe përpilimin e përgjigjes në prapësim konform TOAK.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin PPP.nr.298/2020 të datës 21.02.2022 e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë jashtë fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.345/2020 të datës 29.09.2020.

Gjykata Komerciale e Kosovës, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1244/22 të datës 14.10.2022 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar aktvendimin PPP.nr.298/2020 të datës 21.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit dhe kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohej në tërësi për shkaket si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. FSH-012018 të datës 23.05.2018, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt këtë faturë, e njëjtat nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilat mbështetet propozimi përmbartimor, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2331/22, datë 06.06.2024.

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.